REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1753/3 Prot. Tiranë, më 20.12.2024

**VENDIM**

**Nr. 24, Datë 20.12.2024**

**PËR**

**ZGJEDHJEN E 2 (DY) ANËTARËVE, PËRFAQËSUES TË FAKULTETIT TË ARTEVE TË BUKURA, NË KOMISIONIN E PËRHERSHËM TË PROMOVIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 38, pika 1, germa "i" dhe "j, në nenin 46, pikat 1, 2, 3 dhe 6 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 30, pika 3, germa "b" dhe nenin 35 të Statutit të Universitetit të Arteve, në nenin 21, pika 2, germa "b" dhe nenin 25 të Rregullores së Universitetit të Arteve, në nenin 4, pikat 1, germa "b" dhe 1, germa "s" të Rregullores së Funksionimit të Senatit Akademik në Universitetin e Arteve, në nenin 5, pikat 1, 2 dhe 3 të Rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik (KPPA) të Universitetit të Arteve", miratuar me VSA nr. 18, datë 11.04.2024, në VSA Nr. 22, datë 12.12.2024 "Për caktimin e periudhës së vetëkandidimit për anëtarë në Komisionin e Promovimit të Personelit Akademik, në Universitetin e Arteve", në Procesverbalin e mbajtur nga Sekretariati Teknik i SA, me nr. 1753/2 prot, datë 19.12.2024 ku jepet informacioni mbi personat e vetëkandiduar, pas numërimit të të gjitha fletëve të votimit, të ndara nga Sekretariati Teknik, PRO/KUNDËR/ABSTENIM, në mënyrë unanime,

**VENDOSI:**

1. Të zgjedhë 2 (dy) anëtarët, përfaqësues të Fakultetit të Arteve të Bukura, në Komisionin e Promovimit të Personelit Akademik, në Universitetin e Arteve, si më poshtë:

   - PROF. GAZMEND LEKA
   - PROF. SADIK SPAHIJA

2. Vendimi i kalon për dijeni Bordit të Administrimit në lidhje me efektin financiar.

3. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

**Prof. Dr. Erald BAKALLI**

**Prof. Arben LLOZI**

**Prof. Sadik SPAHIJA**

**Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)**

**Prof. Rudina CIKO**

**Prof. Asoc. Dorian ÇENE**

**Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI**

**Prof. Asoc. Genci FUGA**

**Prof. Asoc. Orion Shima**

**Rei KITA (Student FM)**

**Prof. Najada HAMZA**

**Prof. Miltiadh KUTALI**

**Prof. Lorenc RADOVANI**

**Prof. Endri SINA**

**Prof. Gazmend GJOKA**

**Prof. Asoc. Albes FUSHA**

**Prof. Asoc. Kristina LAÇO**

**Prof. Asoc. Alert ÇELOALIAJ**

**Enea TRIMI (Student FAB)**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE**
**SENATI AKADEMIK**
**SEKRETARIATI**

Nr.1753/2 Prot. Tiranë, më 19.12.2024

## PROCESVERBAL

Në përfundim të afatit të vetëkandidimit për anëtar të Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik të Universitetit të Arteve, sipas Vendimit të Senatit Akademik nr. 22, datë 12.12.2024 "Për caktimin e periudhës së vetëkandidimit për anëtarë në Komisionin e Promovimit të Personelit Akademik, në Universitetin e Arteve" (bashkëngjitur), Ju bëjmë me dije se pranë Sekretariatit të Senatit Akademik, nga data 13.12.2024 e deri më datë 18.12.2024, janë vetëkandiduar dy anëtarë të personelit akademik nga Fakulteti i Arteve të Bukura, si më poshtë vijon:

1. Prof. Sadik Spahija
2. Prof. Gazmend Leka

Dokumentacioni i dorëzuar prej secilit kandidat është:

1. Formulari i aplikimit;
2. Fotokopja e ID;
3. Fotokopja e diplomës së titullit akademik "Profesor";
4. Vërtetimi nga DMBNJISJ-P/A për të dëshmuar se ka përvojë pune si anëtar i personelit akademik për së paku 5 (pesë) vjet pas fitimit të titullit "Profesor" dhe se është i angazhuar me kohë të plotë;
5. Vërtetimi nga DMBNJISJ-P/A që nuk kanë masë disiplinore në fuqi.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

**SEKRETARIATI TEKNIK I SENATIT AKADEMIK**

**Adela Kusuri** **Manjola Thaçi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1753 Prot. Tiranë, më 12.12.2024

**VENDIM**

**Nr. 22, Datë 12.12.2024**

**PËR**

**CAKTIMIN E PERIUDHËS SË VETËKANDIDIMIT PËR ANËTARË NË KOMISIONIN E PROMOVIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 38, pika 1(i), nenin 46 të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 30, pika 3(a) dhe nenin 31 të Statutit të Universitetit të Arteve, në nenin 21, pika 2(a) dhe neni 22 të Rregullores së Universitetit të Arteve, në nenin 4, pikat 1(t) dhe 1(s) të Rregullores së Funksionimit të Senatit Akademik në Universitetin e Arteve, si dhe në shkresat nr. 1726 prot. dhe 1727 prot., datë 06.12.2024, me votim të hapur,

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurës për marrjen e kandidaturave për 2 (dy) anëtarë, përfaqësues të Fakultetit të Arteve të Bukura, në Komisionin e Promovimit të Personelit Akademik në Universitetin e Arteve.

2. 2 (dy) anëtarët e Komisionit, nga 7 (shtatë) anëtarë gjithsej, vetëkandidohen dhe përzgjidhen nga Senati për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

3. Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere:
   a. Të jenë pjesë e personelit akademik me kohë të plotë;
   b. Të mbajnë titullin "Profesor" dhe të kenë së paku 5 (pesë) vite përvojë në mësimdhënie pas fitimit të këtij titulli.

4. Aplikimet duhet të paraqiten pranë Sekretariatit Teknik të Senatit Akademik, nga data 13.12.2024 deri më datë 18.12.2024, nga ora 08:00, deri më 16:00.

5. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
TIRANË

# SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Arben LLOZI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Rudina CIKO

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Prof. Asoc. Genci FUGA

Prof. Asoc. Orion Shima

Rei KITA (Student FM)

Prof. Najada HAMZA

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Lorenc RADOVANI

Prof. Endri SINA

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Kristina LAÇO

Prof. Asoc. Alert ÇELOALIAJ

Enea TRIMI (Student FAB)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI I ARTEVE
TIRANË